

PAKETA E VETË-RRËFIMIT EUR(H)OPE

EUR(H)OPE



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



CEPS Projectes Socials



Q CODE

PROJEKTI EUR(H)OPE

Paketa e Vetë-rrëfimit

PËRMBAJTJA

- HYRJE
 - Rreth Projektit EUR(H)OPE
 - Prezantimi i Paketës së Vetë-rrëfimit
- MODULI 1: Si të Zhvillojmë një Projekt Narrativ
 - Gjurmët e Para të Rrëfimit Narrativ
 - Çfarë është Gazetaria Narrative?
 - Përdorimi i Historive Personale për një Raportim të Angazhuar dhe Autentik
 - Strukturimi i Rrëfimit: Universalizmi përballë Vetë-rrëfimit
- MODULI 2: Verifikimi i Informacionit dhe i Burimeve
 - Rëndësia e Verifikimit: Dezinformimi dhe Keqinformimi
 - Verifikimi dhe Kontrolli i Fakteve
 - Si të Verifikoni Informacionin: Kërkimi dhe Ballafaqim i të Dhënave (triangulation)
 - Si të Verifikoni Burimet
- MODULI 3: Përdorimi i Informacionit dhe i Intervistave
 - Rregulla Bazë për Zhvillimin e Intervistave
 - Si të sigurojmë Pëlqimin e Informuar për Intervistim
 - Udhëzime për Përdorimin e Historive të të Tjerëve
- MODULI 4: Udhëzime për Përdorimin e Imazheve
 - Si të përzgjedhim Imazhe që Përputhen me Rrëfimin Tonë
 - Sugjerime për Linjën Vizuale të Projektit
 - Referimi i Burimeve për Imazhet dhe Prodhimet Fotografike
 - Rregulla për Përdorimin e Drejtë të Imazheve: Lejet dhe Meritat e Autorit
 - Përdorimi i Imazheve në Vetë-rrëfim
 - Elementët e Respektimit të Privatësisë: Shmangia e Narrativave Diskriminuese dhe/apo të Pasjellshme
 - Elementët Ligjorë për Përdorimin e Imazheve të të Miturve dhe Grupeve të Vulnerabël
- MODULI 5: Udhëzime për Arkivimin dhe Post-produksioni
 - Arkivimi i Materialeve
 - Udhëzime për Prodhimin dhe Post-produksionin e Materialeve
- SI TË ZBATOJMË PAKETËN E VETËRRËFIMIT NË PRAKTIKË
 - Si të Ndërtojmë një Histori Vetë-rrëfimi
 - Shembuj dhe Ide për Aktivitete Praktike
- PËRFUNDIME
- FALENDERIME

HYRJE

Rreth projektit EUR(H)OPE

EUR(H)OPE është një projekt 24-mujor, i mbështetur nga programi Erasmus+. Qëllimi kryesor? Të zhvillojë kapacitete për brezin e ri, veçanërisht të rinjve të moshës 18-25 vjeç që jetojnë në komunitetet në kufi të Mesdheut dhe Adriatikut. Projekti i përfshin ata në trajnime praktike dhe aktivitete advokimi, duke përdorur teknikat e gazetarisë dhe metodologjitë e Edukimit Joformal (NFE), për të hapur një diskutim të ri mbi identitetin evropian.

Në këtë nismë janë përfshirë katër organizata jofitimprurëse nga Shqipëria, Italia, Maroku dhe Spanja: Qendra Uja (Tiranë), Shoqata Kulturore QCODE (Milano), Morocco's Friends Foundation (Tiznit) dhe CEPS Projectes Socials (Barcelona).

Por përtej trajnimve dhe shkëmbimeve, EUR(H)OPE ngre një pyetje të rëndësishme: Çfarë domethënie ka Europa sot? Si e shohin të rinjtë konceptin e Europës – ata që janë qytetarë të saj, ata që shpresojnë të bëhen pjesë e saj, apo ata që e zgjedhin për të ndërtuar një jetë të re si emigrantë?

Në këtë projekt, Europa nuk shihet si një hapësirë burokratike, por si një vend ku ndërthuren identitete dhe imagjinata, si një model i demokracisë. Por a e ndiejnë ende kështu të rinjtë nga Spanja dhe Italia? Çfarë mendon rinia shqiptare, një vend që aspiron anëtarësimin në BE? Apo ata nga Maroku, një prej vendeve prej nga ku nisen shumë prej rrugëve migratore drejt Europës?

Të pajisur me mjetet dhe aftësitë e duhura, të rinjtë e këtyre (apo të tjera) vendeve mund të ndërtojnë – sot dhe në të ardhmen – narrativa që pasqyrojnë përvojën dhe zërin e brezit të tyre në qendrat e vendimmarrjes së Bashkimit Europian për të kontribuar me propozime se si mund të konsolidohet dhe të bëhet më inovative ideja e Europës. Dhe nëse këto histori vijnë nga ata që shpesh portretizohen si "zona kufitare", ndikimi i tyre mund të jetë edhe më i madh.

Prezantimi i Paketës për Vetë-rrëfim

Paketa për Vetërrëfim është produkti i parë madhor i projektit EUR(H)OPE, ndërtuar bashkërisht nga katër partnerët ndërkombëtarë dhe testuar në terren gjatë një kursi trajnimi të zhvilluar më 9-13 dhjetor 2024, në Tiranë. Gjatë këtij trajnimi, 13 punonjës rinorë

nga organizatat pjesëmarrëse u njohën me strukturën dhe përmbajtjen e Paketës, duke marrë njohuri dhe aftësi praktike për të analizuar narrativa aktuale, për të zhvilluar intervista dhe për të prodhuar përmbajtje në formatin e vetërrëfimit dhe gazetarisë narrative. Në fokusin e këtij procesi ishte përdorimi i metodologjive të Edukimit Joformal (NFE), për të matur dhe ndarë vizione të përbashkëta përmes intervistimit dhe shkrimit pjesëmarrës. Të gjitha komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve janë integruar në këtë version përfundimtar të Paketës, e cila tashmë është gati për t'u përdorur në terren.

Kjo Paketë bazohet në disa prej mjeteve kryesore të gazetarisë narrative dhe është konceptuar si një manual praktik për të ndërtuar projekte vetërrëfimi apo rrëfimi të realitetit. Në thelb të tij qëndron një qasje pjesëmarrëse, që synon fuqizimin e komuniteteve për të treguar vetë historitë e tyre – me zërin e tyre. Manuali orienton përdoruesit jo vetëm në mënyrën sesi të ndërtojnë një rrëfim të vërtetë dhe të fuqishëm, por edhe në ruajtjen e standardeve bazë të gazetarisë: verifikimi i informacionit, mbrojtja e burimeve, përdorimi i një gjuhe të kujdesshme dhe të respektueshme, dhe ndjeshmëria ndaj konteksteve të caktuara dhe grupeve të marginalizuara.

Ne shpresojmë që kjo Paketë Vetërrëfimi të frymëzojë të rinjtë dhe punonjësit rinorë nga vende të ndryshme të Europës dhe më gjerë, që të ndajnë përvojat dhe këndvështrimet e tyre mbi atë se çfarë do të thotë Europa sot për ta dhe si e përfytyrojnë atë në të ardhmen e afërt përsa u përket respektimit të vlerave mbi të cilat është themeluar. Ai u jep hapësirë për të shprehur si ndikojnë politikat e BE-së në jetën e tyre të përditshme, në arsim, punësim dhe në mundësitë që kanë në një shoqëri gjithnjë e më shumë multikulturore. Gjithashtu, ky proces i fton të rinjtë të reflektojnë mbi sfidat dhe përfitimet e emigracionit dhe integritit, si dhe mbi vizionin e tyre për të ardhmen e Europës – për unitetin, solidaritetin dhe mbrojtjen e vlerave europiane në një kohë kur nacionalizmi dhe populizmi po rriten. Duke u dhënë zë të rinjve dhe komuniteteve që zakonisht mbeten në hije, Paketa për Vetërrëfim hap një dritare të re për të kuptuar më mirë zhvillimin e identitetit europian dhe rolin që brezi i ri ka në formësimin e së ardhmes së këtij kontinenti.

MODULI 1 - SI TË ZHVILLOJMË NJË PROJEKT NARRATIV

Gjurmët e Para të Rrëfimi Narrativ

Debatet mbi origjinën e rrëfimeve narrative dhe gazetarisë janë të shumta. Disa studiues i çojnë hapat e parë të drama dhe mitologjia greke¹, duke e konsideruar rrëfimin si një art të lashtë të ndërlidhur me kulturat e hershme. Të tjerë e vendosin fillimin e gazetarisë narrative në shekullin e 19-të, kohë që shënon edhe atë që F. Scott Fitzgerald e quante "lëvizja letrare e sentimentalizmit"².

Në gjysmën e dytë të këtij shekulli, ndërsa shoqëritë përjetonin ndryshime të thella, gratë luajtën një rol kyç në ruajtjen dhe zhvillimin e këtij stili rrëfimi. Kjo mënyrë e të treguarit vazhdoi të evoluonte edhe në shekullin e 20-të, ku gjatë viteve '60 dhe '70, trazirat sociale dhe politike frymëzuan gazetarët që të sfidonin rregullat e gazetarisë tradicionale dhe të ashtuquajturës objektivitet të ftohtë³.

Çfarë është Gazetaria Narrative?

Një rrefim personal është një proces emocional që ndjek strukturën klasike me një fillim, mes dhe fund⁴. Në këtë udhëtim narrativ, personazhet shpesh përballen me sfida, ndajnë dhimbjen apo shpresat e tyre dhe krijojnë një ndjesi empatie me dëgjuesin ose lexuesin. Në procesin e gazetarisë narrative, kërkohet të ruhet një shkallë objektiviteti, me qëllim kuptimin e domethënies së një ngjarjeje apo situatë dhe trajtimin e saj me qasje analitike në shkrim. Megjithatë, është po aq e rëndësishme të integrohen elemente subjektive – duke përfshirë mendimet dhe ndjenjat personale, për të përcjellë mesazhin me ndjeshmëri dhe vërtetësi⁵. Në fakt, përfshirja e tregimeve personale në raportimin gazetaresk është një mënyrë tepër efektive dhe tërheqëse për ta bërë gazetarinë më të gjallë dhe më afër publikut, sidomos kur trajtohen çështje komplekse dhe thellësisht personale si migrimi dhe identiteti.

Në thelb, gazetaria narrative bashkon përkushtimin e gazetarisë ndaj saktësisë faktike dhe raportimit të ndershëm me elementë narrativë dhe letrarë, të cilët forcojnë aspektet e rrëfimit zhytës të një ngjarjeje reale, duke e bërë atë edhe më tërheqëse dhe më të afërt për lexuesin. Gazetaria narrative njihet me disa emra, ndër të tjera "literary journalism", "creative nonfiction", "long-form storytelling" apo "immersive reporting". Por të gjitha ndajnë një të përbashkët: ndërtimin e një historie reale mbi një strukturë narrative klasike, me elemente të qarta rrëfimi. Kjo përfshin:

¹ van Krieken, Kobie & Sanders, José. (2019). Çfarë Është Gazetaria Narrative? Një Rishikim Sistemik dhe një Agjendë Empirike. *Journalism*. I disponueshëm në:

<https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/1464884919862056>

² Po aty


³ Po aty

⁴ Verghese, A, (1 shtator, 2020). Gazetaria Duhet Të Përfshijë Narrativa Personale. *The Tulane Hullabaloo*. I disponueshëm në :

<https://tulanehullabaloo.com/53850/intersections/journalism-must-include-personal-narratives/>

⁵ Po aty

- Hyrja e rrëfimit (Setup ose Exposition): Vendosja e skenës, konteksti, tema kryesore dhe prezantimi i protagonistëve
- Zhvillimi (Plot): Rrjedha e ngjarjeve që sjell konfliktin qendror dhe ndërton tensionin e historisë.
- Kulmi (Climax): Pika ku gjithçka arrin në një kthesë dramatike, pasuar nga një zgjidhje e mundshme apo reflektim (falling action).
- Mbyllja (Denouement): Përfundimi i tregimit, ku ngjarjet marrin zgjidhje dhe historia përmbyllet.



Burimi: [Storyboard That](#)

Struktura klasike e tregimit narrativ—me hyrje, konflikt, kulm dhe zgjidhje—është një shtyllë kryesore në letërsinë artistike. Në gazetarinë narrative, kjo strukturë e bën historinë tërheqëse dhe ndihmon lexuesin të lidhet emocionalisht me temën. Por ndryshe nga letërsia e trilluar, këtu po tregojmë një ngjarje reale. Dhe kjo e bën edhe më të rëndësishme respektimin e standardeve themelore të gazetarisë: ndershmëria, saktësia dhe transparenca. Në gazetarinë narrative, nuk mund të sakrifikojmë të vërtetën vetëm për hir të një strukture tërheqëse. Çdo fakt duhet të verifikohet dhe çdo burim të jetë i besueshëm. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm në gazetarinë digjitale, një fushë e re që është duke u zhvilluar me ritme të shpejta falë rrjeteve sociale dhe mediave online. Por bashkë me mundësitë për të treguar histori, vijnë edhe sfidat e lajmeve të paverifikuara që shpërndahen shpejt e lehtë.

Përdorimi i Historive Personale për një Raportim të Angazhuar dhe Autentik

Arritja e një shkrirjeje të suksesshme midis raportimit faktik dhe rrëfimit personal është një sfidë për shumë gazetarë, sidomos për ata që janë në hapat e parë ose nuk janë familjarizuar me këtë strukturë. Një pikënisje e mirë mund të jetë identifikimi i çdo interesi personal apo lidhje që mund të kenë me historinë që po trajtoni dhe të përfshini disa elemente nga përvoja juaj personale brenda narrativës, në mënyrë që ta bëni historinë më të afërt dhe të besueshme për audiencën. Kjo qasje është veçanërisht efektive në gazetarinë e formës së gjatë (long-form journalism), por mund të përdoret edhe në format të tjera të raportimit, si në shtypin e shkruar ashtu edhe në platformat online.

Më poshtë janë disa këshilla praktike që mund të ndihmojnë në këtë proces:

- Ji i sinqert, i ndershëm dhe autentik: Rrëfeje historinë tënde personale me ndershmëri, për të krijuar një lidhje të vërtetë me lexuesin. Mos shpik detaje për ta bërë tregimin më emocionues ose për të ngjallur më shumë simpati. Në vend të kësaj, kërko lidhje reale mes teje dhe personazheve të historisë që po ndjek dhe trego se si përvoja jote personale të lejon të ndihesh afër tyre. Kjo krijon një urë të natyrshme besimi me lexuesin.
- Në të njëjtën kohë, njih rolin dhe qëllimin tënd në histori: Trego përvojën tënde vetëm kur i shërben temës kryesore. Mos e vendos veten në qendër të rrëfimit kur kjo mund të zbehtë rëndësinë e zërit të të tjerëve, veçanërisht kur ata përfaqësojnë komunitete të marginalizuara. Rrëfimi yt duhet të jetë një detaj i shijshëm, jo pjata kryesore.
- Prioritet zërave që përjetojnë situatën. Jepu hapësirë dhe përparësi zërave të atyre që e përjetojnë realitetin që po rrëfeni. Më pas, mund të shtoni përvojën tuaj personale si dhe, nëse është e përshtatshme, perspektivat e ekspertëve për të dhënë kontekst dhe detaje të mëtejshme.
- Bëhu i vetëdijshëm për kufizimet dhe paragjykimet personale që mund të jenë duke të penguar për ta rrëfyer ngjarjen të plotë.
- Kontrolllo faktet. Edhe nëse po tregoni historinë tuaj personale, nuk përjashtoheni nga detyrimi për të verifikuar informacionet dhe burimet. Kujtesa njerëzore mund të jetë selektive dhe e pasaktë, përfshirë tuajën!
- Përshkruaj me detaje të gjalla. Përdor gjuhë të pasur dhe përshkrime konkrete për të krijuar një përvojë sa më të gjallë për lexuesin. Thello karakteret dhe situatat, duke mos u shmangur nga kompleksiteti dhe ndonjëherë edhe nga kaosi që mund të përshkruajnë realitetin.
- Mbjaj gjithmonë qëllimin në fokus. Pyet veten: Çfarë dua të them me këtë histori? Çfarë dua që lexuesi të ndjejë ose të mësojë në fund të leximit?
- Mos i neglizho detajet e vogla. Krahas panoramës së gjerë, shpesh janë detajet e vogla ato që i japin thellësi dhe vërtetësi një rrëfimi. Siç thotë gazetari Tom French:

“...duhet të kesh besim tek fuqia dhe rëndësia e momenteve të vogla. Gazetarët shpesh trajnohen që të jenë të shkëlqyer në momentet e mëdha. Por sa më shumë kohë të kalojë, aq më shumë e kuptoj që në ato çaste kur duket sikur nuk po ndodh asgjë përpara meje, mund të ndodhë diçka shumë e rëndësishme. Më duhet thjesht të mësoj të vërej më mirë⁶.”

- Kur ndihesh në dyshim, shkruaj për atë që di, si në aspektin e zërit tënd si autor, ashtu edhe në përzgjedhjen e temave që trajton. Kjo do ta bëjë shumë më të lehtë krijimin e rrëfimeve narrative autentike dhe natyrale, duke nxjerrë në pah stilin dhe zërin tënd si shkrimtar.
- Kujdes: në epokën e internetit, sapo të ndani një histori personale me publikun, ajo mbetet përgjithmonë e lidhur me emrin tuaj. Mendoje dy herë përpara se të postosh: A do të ndihesh mirë me këtë histori pas 5, 10 ose 20 vitesh?
- Së fundi, mos harroni që mund (dhe duhet!) të lexoni e studioni punimet e gazetarëve të tjerë narrativë. Analizoni mënyrat e ndryshme sesi ata ndërthurin historitë e tyre personale me raportimin gazetaresk.

Strukturimi: Universalizmi përballë Vetë-rrëfimit

Siç u përmend më sipër, për të nisur strukturimin e rrëfimit tuaj, fillimisht duhet t’i bëni vetes një pyetje thelbësore: Kush jam unë në këtë histori? Nëse vendosni të përfshini përvoja personale, duhet të keni një kuptim të qartë të qëllimit dhe vendit tuaj brenda tregimit. Por edhe nëse nuk i përfshini ato, është e rëndësishme të kuptoni: pse është e rëndësishme kjo histori; pse je personi i duhur për ta treguar; çfarë nuk të pëlqeu te mënyra se si është treguar më parë; pse personi që ta rrëfen këtë histori duhet të ndihet rahat duke ta treguar ty? Në gazetarinë narrative dallohen dy qasje kryesore:

- 1) Universalizmi: Kjo qasje vë theksin te respektimi i këndvështrimit të personave të përfshirë në histori. Ngjarja e treguar – duke lëvizur nga niveli mikro drejt makros – duhet të arrijë të shpalosë tema universale me interes global.
- 2) Vetë-rrëfimi: Kjo qasje mbështetet te rrëfimi i vetë protagonistëve për jetën dhe përvojat e tyre. Ata përcaktojnë vetë narrativën për veten e tyre, në vend që të jenë objekt i një tregimi që e rrëfen dikush tjetër. Vetë-rrëfimi paraqet një dimension të kundërt me atë të tregimit klasik: nuk është etikisht e drejtë të 'manipulohen' historitë që na besohen, as për hir të një gjuhe më letrare. Ky lloj rrëfimi kërkon kujdes të madh për të respektuar fjalët që protagonistët zgjedhin për të treguar veten e tyre. Është e rëndësishme të kujtojmë se vetë-tregimi nuk është një formë ditari personal, por përfshin hulumtim të thelluar dhe strukturë narrative të qartë.

⁶ Nieman Reports. (15 mars, 2002). Ndarja e Sekreteve për një Gazetari të mirë. *Nieman Reports*. I disponueshëm në: <https://niemanreports.org/sharing-the-secrets-of-fine-narrative-journalism/>

❖ Dallimi mes Vetë-rrëfimit dhe Formës së Ditarit

Vetë-rrëfimi nis me mbledhjen e zërave, burimeve, të dhënave dhe elementeve të tjera që nuk janë vetëm nga këndvështrimi i kronikanit apo gazetarit. Komunitetet e përfshira në një ngjarje sociale, ekonomike apo politike duhet të gjejnë zërat e brendshëm—në përputhje me prejardhjen, arsimimin, kulturën e origjinës, gjuhën amtare dhe të pamediuar, përvojën, njohuritë për kontekstin—që lëvizin brenda realitetit të tyre dhe mund ta rrëfejnë historinë pa stereotipe, pa ekzotizëm dhe pa paternalizëm. Kjo nuk është një qasje as nga lart-poshtë, as nga poshtë-lart, por një metodë që përfshin rrëfimitarët dhe raportuesit në një marrëdhënie në kushte barazie.

Nga ana tjetër, ditari, megjithëse mund të jetë një burim i vlefshëm për narrativën e realitetit, është një mjet komunikimi që nuk është menduar domosdoshmërisht për t'u lexuar nga të tjerët. Edhe kur publikohet më vonë, ai synon të pasqyrojë mendimet dhe ndjesitë personale të autorit, jo t'u japë zë komuniteteve, grupeve apo interesave të veçanta.

Dallimi kryesor mes këtyre dy formave qëndron edhe te gjerësia dhe thellësia që u japim rrëfimeve tona. Në vetë-rrëfim, mbledhim zëra që na ndihmojnë të kuptojmë se si një komunitet i përfshirë në një fenomen dëshiron të tregojë vetë historinë e tij: cilët terma zgjedh të përdorë; cilat fakte i konsideron të rëndësishme; dhe pse. Ky skenar kërkon nga autorët të përballen me ndjeshmëri kulturore dhe me imagjinata shoqërore, të cilat, nëse nuk njihen dhe nuk respektohen, mund të sjellin narrativa toksike ose fyese.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se vetë-rrëfimi nuk përjashton rolin e gazetarit. Përkundrazi, prania e gazetarit pasuron punën narrative, sepse gjithçka që shkruhet do të lexohet—gjë që nuk ka qenë gjithmonë e vërtetë në të kaluarën.

Kjo ndryshon raportin mes komunitetit dhe gazetarit, duke sjellë një barazi ku gazetari mund të përdorë pozicionin e tij për të amplifikuar dhe për të shpërndarë më gjerë zërat e komuniteteve.


MODULI 2 – VERIFIKIMI I BURIMEVE DHE INFORMACIONIT

Verifikimi i informacionit dhe i burimeve të tij është një proces jetik dhe, njëkohësisht, gjithnjë e më i vështirë për t'u realizuar. Sot, rrjetet sociale po luajnë një rol gjithnjë e më të madh, jo vetëm në jetën sociale, por edhe në sferat e të drejtave të njeriut, ligjit dhe sigurisë.

Pikërisht për këtë arsye, është thelbësore të verifikojmë informacionin që marrim, përmes asaj që zakonisht quhet "kontrolli i fakteve" (*fact-checking*).

Rëndësia e Verifikimit: Dezinformimi dhe Keqinformimi

Keqinformimi i referohet informacioneve të rreme ose të nxjerra jashtë kontekstit, të cilat nuk përhapen me qëllimin për të mashtruar. Bëhet fjalë për informacione që janë të pasakta pa dashje, shpesh për shkak të gabimeve njerëzore ose mungesës së kujdesit në raportim. Kjo kategori mund të përfshijë, për shembull: gabime në data, tituj ose emra; informacione të paplota ose të nxjerra jashtë kontekstit; informata të pasakta për shkak të burimeve të pasigurta apo keqinterpretimit.



Burimi: [Open Library, ECampus Ontario](#)

Në anën tjetër, dezinformimi është informacion i rremë që ka për qëllim të mashtrijë ose të çorientojë lexuesit ose shikuesit në lidhje me dikë ose diçka. Kjo shpesh shfaqet në narrativat e manipuluar, ku keqinformimi përdoret për të promovuar një agjendë politike ose pozicion. Sipas Komisionit Europian, dezinformimi (bashkë me manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit nga jashtë) mund të "dëmtojë institucionet dhe proceset

demokratike (si zgjedhjet), duke penguar njerëzit të marrin vendime të informuara ose duke i penguar ata të votojnë. Gjithashtu, ato mund të polarizojnë shoqëritë duke vënë komunitetet në kundërshtim me njëra-tjetrën⁷.”

Shembuj të dezinformimit mund të përfshijnë imazhe, video ose audio të krijuara me "deep fake", të cilat shpesh mund të jenë të vështira për t'u njohur dhe gjithashtu mund të krijohen lehtësisht falë inteligjencës artificiale (AI). Për këtë arsye, përpara se të shpërndani përmbajtje ose ta përdorni atë për qëllime akademike ose profesionale (apo edhe në rrjetet tuaja sociale personale), është e rëndësishme të kontrolloni nëse autori është një burim zyrtar ose një burim i njohur në fushën përkatëse, dhe nëse historia është raportuar ose verifikuar nga individë ose entitete të tjera.



Burimi: [Christian Hetrick, USC Price](#)

Verifikimi dhe Kontrolli i Fakteve

Përfshirja e historive personale në raportimin gazetaresk mund të jetë një mjet i fuqishëm për të lidhur me audiencën dhe për të ofruar raportime të thelluara dhe të kuptueshme mbi tema të ndjeshme ose komplekse. Si gazetarë, gjithmonë kemi përgjegjësinë për të konfirmuar të vërtetën dhe saktësinë e asaj që shkruajmë. Ne duhet të jemi të sigurt për të verifikuar informacionin që na jepet, si dhe burimet. Kjo do të thotë të sigurohemi që faktet, deklaratat, teoritë dhe informacionet e tjera janë objektivisht të vërteta duke zgjeruar pretendimet e tyre dhe/ose duke i krahasuar ato me të dhëna të tjera. Është e

⁷ Komisioni European. (2024). Komunikimi strategjik dhe lufta kundër manipulimit të informacionit. *Komisioni European*. E disponueshme në: https://commission.europa.eu/topics/countering-information-manipulation_en

rëndësishme të bëjmë një dallim midis verifikimit të lajmeve nga një këndvështrim gazetaresk dhe kontrollit të fakteve.

1. Verifikimi është një teknikë editoriale e përdorur për të vlerësuar dhe konfirmuar saktësinë dhe përmbushjen e një pjesë të lajmeve ose një deklaratë⁸.
2. Kontrolli i fakteve është vetëm një metodë e aplikuar verifikimi në fushën e gazetarisë, që përfshin konfirmimin e vërtetësisë së të gjitha fakteve të përfshira në një pjesë lajmesh.

Kur përpiqeni të verifikoni informacionin, është e rëndësishme t'i bëni vetes këto pyetje nga fillimi:

- Kush e thotë këtë?
- Si e dinë ata?
- Cilat janë paragjykimet e tyre?
- Çfarë mund të mungojë?

Si të Verifikoni Informacionin: Kërkimi dhe Ballafaqimi i të Dhënave (Triangulation)

Kërkimi është një nga parimet kryesore të gazetarisë së mirë, pasi të gjithë gazetarët duhet të mbledhin informacion dhe pastaj të kontrollojnë faktet për të verifikuar të gjitha informacionet që ata kanë përfshirë. Ky është edhe ai dallim që ndan narrativën jofikive nga ajo fikive, pasi historitë reale kërkojnë një shkallë shumë më të lartë të vërtetësisë. Si pasojë, të gjithë gazetarët përdorin strategji të ndryshme kërkimi për të konfirmuar faktet, shifrat, deklaratat dhe pjesët e tjera të informacionit që përbëjnë një histori lajmesh. Këto strategji mund të klasifikohen në dy lloje kryesore: kërkimi primar dhe kërkimi sekondar.

- Kërkimi Primar

Ky është gjithë kërkimi dhe hetimi që një gazetar bën në mënyrë të parë, i cili shpesh përfshin realizimin e intervistave, anketave ose eksperimenteve; mbështetjen në vëzhgime të para ose përvoja personale; ose angazhimin aktiv në çdo lloj tjetër grumbullimi të njohurive të para.

- Kërkimi Sekondar

⁸ Silverman, Craig. (2014). Verifikimi dhe kontrolli i Fakteve. *Manuali i Verifikimit*. I disponueshëm në: <https://datajournalism.com/read/handbook/verification-1/additional-materials/verification-and-fact-checking>

Ky është mbledhja e të dhënave dhe informacionit përmes burimeve të shkruara dhe të publikuara nga autorë të tjerë. Kjo mund të përfshijë publikime si gazeta, libra, artikuj, baza të të dhënash dhe vlerësime, si dhe mbledhjen e informacionit nga lloje të tjera burimesh, si efektet personale dhe arkivat.

Kërkimi primar kërkon që gazetarët të angazhohen drejtpërdrejt në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, ndërsa kërkimi sekondar kërkon që ata të konsultohen dhe analizojnë të dhëna, fakte dhe situata duke përdorur burime online, biblioteka dhe arkiva. Kërkimi primar shpesh është më i dobishëm në krijimin e një strukture narrative dhe në përmbushjen e shumë detajeve kryesore të një historie, ndërsa kërkimi sekondar ndihmon në zbërthimin e detajeve mbështetëse që e pasurojnë historinë dhe e bëjnë atë më të besueshme, të vërtetë dhe tërheqëse.

- Ballafaqimi i të Dhënave (triangulation)

Përveç mbledhjes dhe kontrollit të fakteve përmes këtyre metodave kërkimore, gazetarët gjithashtu përdorin një metodë tjetër të rëndësishme verifikimi të quajtur ballafaqimi i të dhënave. Kjo do të thotë kontrollimi i çdo informacioni kundër një ose më shumë burimesh të tjera—qoftë njerëz, artikuj, libra, etj.—për të konfirmuar që të njëjtin fakt është i vërtetë për shumë persona ose në kontekste të ndryshme.

- Për shembull, nëse intervistojmë dikë për përvojën e tij në një protestë, duhet gjithashtu të përpiqemi të intervistojmë pjesëmarrës të tjerë për të parë nëse rrëfimet e tyre për ngjarjen janë të qëndrueshme. Sa më shumë njerëz që konfirmojnë një ide ose përvojë, aq më shumë është e mundur që ajo të jetë e vërtetë.

Një element tjetër i rëndësishëm i triangulimit të të dhënave është përdorimi i të dhënave nga një larmi burimesh, metodash ose qasje të teorike për të ndihmuar në konfirmimin e informacionit tonë dhe për të shmangur nxjerrjen e përfundimeve të paragjykuara nga të dhënat që kemi interpretuar.

- Duke vazhduar shembullin, ndërsa pjesëmarrësit e protestës mund të ndajnë narrative të ngjashme për atë që ka ndodhur, kjo nuk përjashton mundësinë që ata të ndajnë këtë narrative për një qëllim të caktuar, ose që pikëpamja e tyre e përbashkët i bën ata ta interpretojnë ngjarjen në mënyrë të ngjashme. Prandaj, mund të flasim gjithashtu me ndonjë kalimtar që nuk ka marrë pjesë, organizatorët e protestës, ose madje forcat e policisë që ishin të pranishme për kontrollin e turmës, për të marrë një larmi pikëpamjesh, që më pas lehtëson kuptimin e kontekstit të plotë dhe ofron një pamje më objektive të asaj që ndodhi në protestë.



Burimi: [Good Governance Institute](#)

Këtu janë disa sugjerime të dobishme për verifikimin e informacionit që përdorni në historitë tuaja:

- Zgjidhni burimet e duhura të informacionit që nga fillimi. Sigurohuni që burimet tuaja të jenë gjithëpërfshirëse, të përshtatshme për historinë që po shkruani, përfaqësuese të grupit ose komunitetit që po trajtoni, dhe, mbi të gjitha, burime të besueshme dhe të besueshme me një reputacion për të thënë të vërtetën⁹. (Ne do ta shqyrtojmë këtë më në detaje në pjesën tjetër të këtij moduli!)
- Filloni me supozimin se çdo “fakt” që përfshini në historinë tuaj mund të mos jetë i vërtetë, dhe përpikuni ta provoni saktësinë e tij nga ky këndvështrim. Kjo do të thotë të pyesni veten se pse mund të jetë i vërtetë ose i gabuar, si e dimë këtë, cilat lloj supozimesh dhe paragjykimesh mund të ndikojnë në një deklaratë, dhe përse lexuesit duhet ta besojnë që ky fakt është i vërtetë¹⁰. Duhet ta bëni këtë për çdo fakt që përfshini!
- Kontrolloni dy herë detajet e vogla, por të rëndësishme: Shkrimi i emrave, kompanive, titujve, dhe emrave të vendeve; shifrat ose statistikat që përfshini; referencat për kohën dhe datat; të gjitha citimet direkte nga individë dhe burime të tjera; dhe të gjitha argumentet ose narrativat që shkruani dhe që varen nga faktet, duke u siguruar që ato janë të qëndrueshme logjikisht me faktet¹¹.

⁹ Baker, Allison & Fairbank, Viviane. (2022). Manuali i Reporterëve për Gazetarinë e Mbështetur në Kontrollin e Fakteve. *E vërteta në Manualin e Gazetarisë së Mbështetur në Kontrollin e Fakteve*. I disponueshëm në: <https://thetijproject.ca/guide/reporter-guidelines/>

¹⁰ Zamith, Rodrigo. (2022). Verifikimi i Informacionit. *Manuali i Gazetarisë Amerikane: Koncepte, Tematika, dhe Aftësi*. I disponueshëm në:

¹¹ Po aty.

- Pas kësaj, sigurohuni që pjesët të përputhen me tërësinë. Kontrolloni dy herë që të gjitha faktet që keni verifikuar jo vetëm që janë të vërteta, por gjithashtu kanë kuptim dhe ruajnë vërtetësinë e tyre kur shihen në kontekstin e pasqyrës më të gjerë. Siç thotë shprehja e vjetër, “Mos e humbisni pyllin për pemët” (do të thotë, mos humbisni të kuptuarit e situatës së plotë sepse jeni të fokusuar në disa pjesë të saj). Këtu, si pylli ashtu edhe pemët duhet të verifikohen! ☺
- Jini sa më të hapur të mundeni. Sigurohuni që lexuesit tuaj jo vetëm që të jenë të vetëdijshëm që keni verifikuar informacionin tuaj, por gjithashtu të jenë të informuar për metodat dhe proceset tuaja të verifikimit, si dhe motivet tuaja për të shkruar historinë¹². Ky është një faktor kyç, pasi transparenca ka një rol të madh në besueshmërinë tuaj si gazetar dhe tregimtar.
- Krijoni një listë verifikimi për të përshpejtuar procesin, ku pyesni veten gjëra si:
 - A kam konfirmuar ose verifikuar saktësinë e të gjitha deklaratave ose elementeve që paraqiten si fakte në historinë time?
 - A kam marrë parasysh paragjykimet që mund të ndikojnë në këto fakte para se të vazhdoj me verifikimin?
 - A kam kontrolluar dy herë shkrimin e emrave dhe vendeve, saktësinë e numrave dhe citimeve, dhe versionin përfundimtar të çdo teksti të përditësuar në lidhje me faktet që kam kontrolluar (nëse janë bërë ndonjë ndryshime)?
 - A mund të verifikoj të gjitha faktet me burime autoritative (dhe idealisht burime primare)?
 - A janë të gjitha këto fakte të verifikuara të përputhura në kontekstin e tërë historisë? A ka kuptim si një e tërë?
 - A kam bërë të qartë që historia ime është faktikisht e saktë dhe e besueshme, dhe kam përmendur metodat e mia për verifikimin e informacionit?
 - Dhe çdo konsideratë tjetër që mund të gjeni të dobishme për të shtuar në listën tuaj për të përshpejtuar procesin e verifikimit dhe për ta bërë atë një veprim të natyrshëm. ☺


¹² Instituti i Rrjetit Evropian për Kujtesën dhe Solidaritetin. (2021). Si e Verifikojnë Gazetarët Informacionin. *Mësime Hi-Story*. I disponueshëm në: https://hi-storylessons.eu/wp-content/uploads/2021/02/9_J.Godole_How-Journalists-Verify-Information_EN.pdf

Si të Verifikoni Burimet

Me përparimet e jashtëzakonshme të internetit dhe mediave digjitale gjatë tri dekadave të fundit, si dhe me ardhjen e ciklit të lajmeve 24-orësh, tani kemi informacion thuajse të pakufizuar në gishtat e dorës, i disponueshëm në çdo moment të ditës ose natës. Si rezultat, është më e rëndësishme se kurrë të dimë si të identifikojmë burimet e mira dhe të verifikojmë besueshmërinë e tyre dhe vërtetësinë e informacionit që ata ndajnë.

Një aplikim veçanërisht pozitiv i kësaj ideje, që “çdokush mund të jetë një reporter në internet,” është zhvillimi i gazetarisë qytetare, veçanërisht në lidhje me lëvizjet politike (siç e kemi parë gjatë Pranverës Arabe dhe protestave të Black Lives Matter) dhe në kontekstin e shumë luftërave në mbarë botën, ku gazetarët tradicionalë shpesh nuk kanë mundësi të raportojnë, censurohen, ose madje vriten për shkak të raportimeve të tyre.

Megjithatë, ana negative e kësaj deklarate e tradhton faktin se sot, pothuajse çdo njeri mund të kontribuojë me historitë e tij personale, narrativat, pikëpamjet dhe informacionet në bankën e madhe të burimeve që ndodhen në internet, shpesh me opinione që prezantohen si fakte dhe pa asnjë transparencë mbi motivet e tyre. Si rezultat, është gjithnjë e më e zakonshme të shohim dezinformata, informacion të pasaktë dhe “lajme të rreme” që qarkullojnë në faqe interneti dhe rrjetet sociale për një gamë të gjerë temash: nga politika dhe ngjarjet aktuale deri te shëndeti, thashethemet për njerëz të famshëm dhe shumë më tepër.



Burimi: Kopja e butë via [News Literacy Matters](#)

Realiteti aktual çon në një nevojë edhe më urgjente për verifikimin e informacionit dhe identifikimin e burimeve të besueshme nga të dy anët: së pari, si gazetarë ose rrëfimtari, ne duhet të sigurohemi që të verifikojmë informacionin dhe burimet tona, dhe së dyti, si lexues, gjithashtu duhet të marrim përgjegjësinë e shtuar për të vlerësuar se çfarë është e

vërtetë ose faktike dhe çfarë na thonë këto përshkrime narrative të realitetit¹³. Kjo do të thotë jo vetëm të dimë si të identifikojmë burime të besueshme, por gjithashtu të ushtrijmë mendimin kritik dhe aftësitë e mira të edukimit mediatik (media literacy) ndërsa interpretojmë informacionin që na jepet nga një shumëllojshmëri burimesh.

Ja disa këshilla të dobishme për identifikimin e burimeve të besueshme:

- Burimet e besueshme zakonisht kanë një farë autoriteti në fushën përkatëse, qoftë për shkak se janë institucione të njohura ose kanë ekzistuar për një kohë të gjatë (dhe kështu kanë treguar se janë faktike dhe të besueshme me kalimin e kohës), ose për shkak se janë jashtëzakonisht transparente në lidhje me metodat e kërkimit, shkrimit dhe verifikimit dhe japin një rëndësi të madhe për t'i realizuar këto procese siç duhet.
- Burimet e besueshme gjithashtu mund të jenë autoritative sepse ofrojnë informacion të parë rreth temave të interesit dhe mund të mbështesin vërtetësinë e këtij informacioni.
- Besueshmëria e një burimi varet nga tema specifike që trajton dhe konteksti specifik në të cilin funksionon. Për shembull, në shumë vende perëndimore, gazetat kryesore dhe revistat zakonisht ofrojnë raporte më të besueshme se pjesët e tjera të shkruara dhe të publikuara nga individë që nuk janë të konsoliduar në fushën përkatëse. Po ashtu, statistikat zyrtare të qeverisë mund të jenë më të besueshme dhe të sakta sesa rezultatet e një ankete të kryer nga individë me një agjendë të caktuar. Megjithatë, të gjitha burimet duhet të lexohen me kujdes, pasi edhe burimet që janë përgjithësisht të besueshme mund të shkruajnë (dhe shpesh shkruajnë!) me një paragjykim ose agjendë në mendje.
- Në përgjithësi, mund të vlerësoni besueshmërinë e burimeve duke drejtuar disa pyetje bazike dhe duke interpretuar përgjigjet brenda kontekstit tuaj specifik¹⁴:
 - Kush është autori? (Autori)
 - Nga vjen burimi? (Botuesi)
 - Për kë është bërë? (Audienca)
 - Cili është qëllimi i punës? (Qëllimi / Motivii)
 - Në cilin kontekst është paraqitur ky punim? (Konteksti)
 - Nga vjen informacioni që ata përdorin? (Besueshmëria e burimeve)

¹³ van Krieken, Kobie & Sanders, José. (2019). Çfarë Është Gazetaria Narrative? Një Rishikim Sistemik dhe një Agjendë Empirike. *Journalism*. I disponueshëm në:

<https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/1464884919862056>

¹⁴ Information synthesized from: University Libraries, University of Washington. (9 January 2025). FAQ: How do I know if my sources are credible/reliable?. *Research Guides*. Available at:

<https://guides.lib.uw.edu/research/faq/reliable>

- Si krahasohet ky burim me të tjerët? (Verifikimi i informacionit)
 - Rishikoni: A ka ndonjë gjë që ju duket e dyshimtë ose e pavërtetë? (Të shihni pamjen e plotë)
 - Si do ta përdorni këtë informacion në punën tuaj? (Aplikimi)
- Për faqet e internetit, konsideroni elementët më poshtë:
 - Autori: A janë të listuar? A bëjnë pjesë në një organizatë akademike, shkencore, qeveritare, ose organizatë tjetër që mund të përgjigjet për ta dhe që ka pjesë të tjera të besueshme online?
 - Data: A është ky informacion i kohëve të fundit ose i përditësuar mjaftueshëm për qëllimet tuaja? Kjo mund të ndryshojë në varësi të kontekstit dhe temës që po shkruani.
 - Burimet e tyre: A përdorin ata burime të besueshme dhe i citojnë ato siç duhet?
 - Domeini: Përdorimi i domenëve .com, .org, dhe .net mund të blihet dhe përdoret nga individë, por domenët .edu dhe .gov i përkasin universiteteve të regjistruara dhe faqeve qeveritare, përkatësisht.
 - Dizajni i faqes dhe stili i shkrimit: Gabime të shumta në shkronja dhe gramatikë, madje dhe një faqe interneti me dizajn të dobët mund të tregojnë se burimi është më pak i besueshëm, pasi burimet e besueshme zakonisht redaktojnë dhe përpiqen të paraqesin përmbajtjen e tyre në mënyrën më të qartë të mundshme, përfshirë respektimin e rregullave të gramatikës dhe shpesh krijimin e një dizajni tërheqës.
 - Në përfundim, kujtoni që përdorimi i burimeve të besueshme është thelbësor për të ndërtuar një raportim etik dhe për të rritur besueshmërinë tuaj si shkrimtar, sepse lexuesit e dinë që mund t'ju besojnë për të thënë të vërtetën.
 - Po ashtu, përdorimi i aftësive tuaja të mendimit kritik është një pjesë kyçe në verifikimin e vërtetësisë së të gjitha fakteve individuale që përdorni si dhe të gjithë tregimin që ato krijojnë.

MODULI 3 - PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE INTERVISTAVE

Udhëzime për Intervistat

Siç kemi theksuar edhe më herët, një aspekt veçanërisht i rëndësishëm si i gazetarisë narrative, ashtu edhe i vetë-rrëfimit, është aftësia për të shpërndarë dhe amplifikuar zërat e marginalizuar, veçanërisht ata që nuk kanë qasje në pajisje të përshtatshme teknologjike apo në audiencë të gjerë për të rritur ndërgjegjësimin për situatat e tyre. Vetë-rrëfimi, në mënyrë të veçantë, ofron një mundësi të shkëlqyer për komunitete apo individë që të tregojnë historitë e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë (në frymën e gazetarisë qytetare), ose për t'i treguar ato nëpërmjet ndihmës së një gazetari, i cili mbledh informacionin, strukturon tregimin dhe ndihmon në amplifikimin e mesazhit duke e shpërndarë atë në formate apo media të reja, gjithnjë në një mënyrë plotësisht pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë, marrëdhënia e besimit mes rrëfimitarit dhe mbledhësit të historisë është thelbësore, për të shmangur paragjykimet narrative, qëndrimet paternaliste dhe stereotipet ose tregimet e njëanshme për njerëzit që gjenden në qendër të këtyre historive. Qëllimi ynë në projektin EUR(H)OPE është që të rinjtë dhe emigrantët të bëhen subjekt, jo objekt i raportimeve mbi migracionin, pasi ata janë ekspertët e vërtetë të situatave, përvojave dhe identiteteve të tyre.

Pavarësisht se cilën qasje të vetë-rrëfimit do të zgjidhni të ndiqni, është shumë e mundshme që do t'ju duhet të përgatisni dhe zhvilloni intervista për të kuptuar më në thellësi historinë që dikush dëshiron të tregojë, ose për të mbledhur këndvështrime apo elemente të tjera që mund ta pasurojnë tregimin tuaj. Në këtë pjesë, ju paraqesim një përmbledhje të qartë të elementeve që duhet të mbani parasysh për të organizuar dhe realizuar intervista të suksesshme.

1. Zgjedhja e pyetjeve dhe përgatitja për intervistë

Sipas autores Serena Carpenter dhe kolegëve të saj, gazetarët ose intervistuesit/et duhet të krijojnë një ndjenjë intimiteti me burimin, në mënyrë që ta inkurajojnë atë të "shpalosë besimet, përvojat dhe njohuritë e tij/saj" gjatë ndërveprimit. Më poshtë, paraqesim analizën e Carpenter dhe kolegëve të saj, e cila përshkruan hapat që duhen ndjekur për të arritur atë që ata e quajnë Kompetencat e Intervistimit Gazetaresk (JIC). Këto janë

elementë kyç që na ndihmojnë të hartojmë pyetje të qarta, koherente dhe tërheqëse dhe të përgatitemi siç duhet për vetë intervistën.

1. Kërkimi

Hartimi i një liste pyetjesh përmes hulumtimit mbi personin që intervistohet dhe temën e tregimit i ndihmon gazetarët të menaxhojnë më mirë intervistën, duke parashikuar shqetësimet apo ndjeshmëritë e mundshme të të intervistuarit.

2. Dëgjimi

Një intervistë duhet të ngjasojë me një bisedë të natyrshme, ku intervistuesi kalon shumicën e kohës duke dëgjuar, duke bërë pyetje shtesë dhe duke përdorur empatinë për të ndërtuar besimin dhe përmirësuar komunikimin.

3. Aspektet profesionale

Gazetarët duhet të i qasen intervistave sikurse një interviste pune: duke u veshur në mënyrë profesionale, duke qenë të sjellshëm dhe duke arritur në kohë.

4. Artikulimi

Gazetarët duhet të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të qartë, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe pa zhargon, për të siguruar një rrjedhë të qetë të bisedës dhe për të shmangur keqkuptimet.

5. Menaxhimi i ndërveprimit

Gazetarët duhet të menaxhojnë rrjedhën e intervistës, duke balancuar kontrollin pa dominuar bisedën, si dhe duke menaxhuar kohën ndërkohë që ndërtojnë marrëdhënie të mirëbesimit me të intervistuarin.

6. Sjelljet joverbale

Gjuha e trupit, shprehjet e fytyrës dhe toni i zërit kanë një ndikim pozitiv në ndërveprim, duke udhëhequr bisedën dhe duke ndihmuar në ndërtimin e një klime besimi¹⁵.

¹⁵ Carpenter, Serena; Cepak, Anthony & Peng, Zhao. (2018). Një Eksplorim i Kompleksitetit të Aftësive të Intervistimit Gazetaresk. *Studime mbi Gazetarinë*. I disponueshëm në: https://www.researchgate.net/publication/317826689_An_Exploration_of_the_Complexity_of_Journalistic_Interviewing_Competencies

2. Elementët Teknikë të Regjistrimit

Në punimin e tyre "Udhëzues 'Si të' për Prodhimin e Intervistave të Regjistruara", Rhianna Pedwell dhe kolegët e saj përshkruajnë disa nga hapat kryesorë për të mbledhur materiale që përmbushin standardet ideale të filmimit ose regjistrimit të intervistave:

- Vizitoni vendin ku do të zhvillohet intervista përpara ditës së planifikuar, idealisht në të njëjtën orë kur do të ndodhë intervista, dhe vini re çdo zhurmë që mund të jetë shpërqendruese në regjistrimin përfundimtar.
 - Regjistroni veten duke folur aty, ose kërkoni ndihmën e një miku që të luajë rolin e të intervistuarit.
 - Pas dëgjimit të audios, nëse vini re probleme si jehona, zhurma të sfondit ose probleme me volumin, rekomandohet të rregulloni konfigurimin tuaj teknik (vendndodhjen e mikrofonit, pajisjet e përdorura etj.).
 - Gjithmonë sigurohuni që keni një plan rezervë, për shembull duke përdorur një pajisje të veçantë jashtë kuadrit për të regjistruar audion, në rast se ndodh ndonjë problem teknik me pajisjen kryesore¹⁶.
-

3. Elementët e Vendndodhjes

Një tjetër aspekt kyç për përgatitjen e një interviste është marrja në konsideratë e elementëve të vendndodhjes dhe mënyra si mund të regjistroni intervistën në mënyrë të suksesshme, sidomos kur rezultati përfundimtar do të prezantohet në format video (disa këshilla praktike të përmbledhura nga *MediaCollege.com*¹⁷)

1. Sfondi

Sfondi i intervistës duhet të ketë lidhje me të intervistuarin dhe temën që po trajtohet. Sigurohuni që mund të ndryshoni apo rregulloni elementë të vendit ku do filmoni, për të lëvizur objekte që mund të jenë shpërqendruese. Sigurohuni që i intervistuari të jetë në qendër të vëmendjes, të duket qartë dhe pa pengesa në sfond.

2. Ndriçimi

Përdorni ndriçim natyral sa herë që është e mundur, duke e pozicionuar dritën

¹⁶ Pedwell, Rhianna; Hardy, James & Rowland, Susan. (2018). Një Udhëzues "Si të..." për Prodhimin e Intervistave të Regjistruara. CourseSource. I disponueshëm në:

file:///C:/Users/Perdorues/Downloads/A_How-to_Guide_For_Producing_Recorded_Interviews.pdf

¹⁷ <https://www.mediacollege.com/>

përpara të intervistuarit, jo pas tij/saj. Shmangni filmimin me një dritë të fortë prapa, sepse mund të errësojë fytyrën e tyre. Gjithashtu, kini kujdes me ndriçimin shumë të ashpër, siç është drita direkte e diellit, që mund të krijojë hije të padëshiruara.

3. Kuadri

Sigurohuni që sfondi të mos shpërqendrojë nga mesazhi i të intervistuarit. Shmangni përmbajtjen e papërshtatshme ose të mbrojtur nga të drejtat e autorit dhe hiqni çdo element që mund të krijojë një paraqitje të sikletshme, si hije të pakontrolluara apo objekte që duken sikur "dalin" nga koka e të intervistuarit. Kontrolloni gjithmonë kuadrin për të ruajtur një paraqitje profesionale.

4. Metoda angazhimi me të Intervistuarin/ën

Gjatë intervistës, angazhimi me të intervistuarin/ën është thelbësor për të grumbulluar materialin që dëshironi dhe për të krijuar një tregim të mirë. Ja disa pika që ju rekomandojmë të mbani parasysh për të garantuar një bashkëbisedim efektiv:

Pika	Përmbledhje
Takimi Para-Intervistës	Organizoni një takim paraprak për t'u familjarizuar; diskutimet para intervistës ndihmojnë për të zbutur emocionet që vijnë nga filmimi.
Dëgjimi Aktiv	Dëgjoni me vëmendje, mbani kontakt vizual dhe vlerësoni rëndësinë e përvojave që ndan i intervistuari.
Renditja e Pyetjeve	Bëni pyetjet në një rend logjik dhe përdorni pyetje ndjekëse për të marrë më shumë detaje dhe për të treguar respekt ndaj personit që intervistoni.

Sqarimi dhe Parafrazimi Sqaroni ose parafrazoni përgjigjet për të siguruar kuptimin dhe për të treguar se e vlerësoni kontributin e tyre.

Sinjalet Joverbale Vini re gjuhën e trupit dhe shprehjet e fytyrës për të kuptuar nivelin e rehatisë së të intervistuarit dhe për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi miqësor.

5. Ruajtja e Materialeve

Një aspekt përfundimtar, por jashtëzakonisht i rëndësishëm i intervistave, është që materialet e mbledhura (qoftë audio, video apo edhe shënime) të ruhen dhe të arkivohen siç duhet. Këto materiale duhet të ruhen në vende të sigurta, ku vetëm anëtarët e autorizuar të organizatës tuaj mund të kenë akses. Po ashtu, është e këshillueshme të krijoni një kopje rezervë për të garantuar që informacioni i mbledhur të mos humbasë dhe të mos shkaktojë probleme në procesin e prodhimit të materialeve përfundimtare.

- Përdorni zgjidhje të besueshme për ruajtje dixhitale, si cloud storage (server online me akses të kontrolluar) dhe disqe të enkriptuara, për të mbrojtur intervistat e regjistruara nga humbja ose aksesimi i paautorizuar.
- Krijoni kopje rezervë të të gjitha regjistrimeve dhe ruajini në vende të ndara gjeografikisht ose në pajisje të ndryshme, për të parandaluar humbjen e të dhënave në rast emergjence.
- Etiketoni dhe organizoni të gjitha skedarët në mënyrë të qartë, duke përdorur emërtime të lehta për t'u identifikuar, data dhe informacione bazë, për të siguruar gjetjen e shpejtë dhe referencën e saktë kur të jetë e nevojshme.
- Qasja në regjistrime duhet të kufizohet vetëm për personat e autorizuar, për të ruajtur konfidencialitetin dhe sigurinë gjatë gjithë procesit të projektit të vetë-rrëfimit.

Marrja e Lejes për Intervistë: Pëlqimi i Informuar

Sa herë që kemi për të zhvilluar dhe ndarë intervista dhe historitë tona gazetareske, është thelbësore të marrim leje nga burimet tona përpara intervistimit të tyre dhe të trajtojmë siç duhet informacionin e tyre personal, si gjatë intervistës ashtu edhe më pas.

Gazetaria etike kërkon nga gazetarët pëlqimin e burimeve për të përdorur tregimet, deklaratat dhe çdo informacion tjetër që ata ndajnë me ne në raportimet tona – pavarësisht nga formati që zgjedhim për të treguar historinë. Në mënyrë specifike, kërkohet të marrim pëlqimin e informuar të burimeve tona si për pjesëmarrjen e tyre në intervista, ashtu edhe për përdorimin e informacionit që ata/ato ndajnë me ne në historitë tona.

❖ Çfarë është pëlqimi i informuar?

- Një deklaratë formale e shkruar ose dokument i nënshkruar nga burimi ose pjesëmarrësi, ku ata shprehin pajtimin e tyre për të ndarë informacion personal mbi një temë dhe për ta përfshirë atë informacion në historinë tuaj.
- Për të dhënë pëlqimin e tyre të plotë burimi duhet të kuptojë dhe të pajtohet jo vetëm me ndarjen e informacionit, por edhe me qëllimin dhe mënyrën se si do të përdoret informacioni i tyre më pas.
- Është gjithashtu thelbësore që pëlqimi të merret në rrethana që sigurojnë se personi nuk është i detyruar në asnjë mënyrë për të marrë pjesë¹⁸. Kjo do të thotë që nuk duhet të ketë presion, mashtrim ose stimuj të tjerë që mund të ndikojnë tek vendimi i tyre.
- Në rastin e fëmijëve, pëlqimi duhet të jepet nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë.
- Pëlqimi i informuar aplikohet për çdo lloj pjesëmarrjeje nga ana e burimeve tona: dhënia e një intervistë, fotografimin e tyre, regjistrimin e audios apo videos, etj.
- Është e rëndësishme që pëlqimi i informuar të mos mbetet thjesht verbal, por të konfirmohet me shkrim (ose përmes një regjistrimi audio/video). Kjo mund të realizohet në disa mënyra, si për shembull: përmes një letre të firmosur, një email-i, një video regjistrimi, etj. Megjithatë, më e zakonshme është nënshkrimi i një dokumenti specifik, i cili konfirmon qartë pëlqimin e informuar të pjesëmarrësit për të gjitha aktivitetet që përfshihen në procesin e intervistës.

Më poshtë gjendet një shembull i Formularit të Pëlqimit të Informuar, i mundësuar nga organizata *Philanthropy Without Borders*¹⁹. Mund ta përdorni si bazë për të krijuar formularin tuaj të pëlqimit, duke e përshtatur sipas nevojave dhe kontekstit specifik të projektit apo organizatës suaj!

¹⁸Grupi i Komunikimit i Kombeve të Bashkuara. (Dhjetor 2016). *Udhëzime Etike për Gazetarët*. UNICEF.org. E disponueshme në:

https://www.unicef.org/afghanistan/media/2136/file/afg-publication_UN%20Ethical%20Guidelines%20for%20Journalists%20-%20English.pdf%20.pdf

¹⁹ <https://philanthropywithoutborders.com/consentform/>

FORMULAR PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE MEDIATIKE (Shkarko)

❖ Përpunimi i të dhënave personale

Si gazetarë dhe rrëfimtari, kemi gjithashtu një detyrim për të mbrojtur burimet tona nga çdo dëm ose pasoja negative, sa më shumë që të jetë e mundur. Pjesë e procesit të marrjes së pëlqimit të informuar përfshin një bisedë të detajuar (shpesh të vazhdueshme) me burimet tona lidhur me historinë që po shkruajmë, si kontribuon informacioni i tyre në atë histori, dhe çfarë lloj pasojash mund të kenë kur kjo histori publikohet dhe identifikohen publikisht me të. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e të rinjve dhe njerëzve në rrethana të marginalizuara.

Në disa raste, mund të zgjedhim të mbrojmë konfidencialitetin e burimeve tona për t'i mbrojtur ata/ato nga pasoja negative. Kjo mund të nënkuptojë fshehjen e disa detajeve që mund t'i identifikojnë ata/ato publikisht, ose mund të nënkuptojë mbajtjen tërësisht anonime të burimeve tona.

Përveç kësaj, sa herë që trajtojmë të dhënat personale të burimeve tona, duhet të respektojmë të gjitha ligjet në fuqi lidhur me përpunimin e të dhënave private ose të ndjeshme. Në Europë, kjo nënkupton respektimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), e cila rregullon mënyrën se si mbledhim, përpunojmë dhe ruajmë të dhënat personale të qytetarëve të BE-së²⁰. Kjo rregullore kërkon që të përcaktojmë dhe të komunikojmë qartë pse, kur dhe si po përpunohen këto të dhëna personale, si dhe ndikimin e përpunimit të tyre. Gjithashtu, është e nevojshme të merret pëlqimi i informuar për përpunimin e tyre. Në terma praktikë, edhe nëse nuk trajtojmë sasi të mëdha të të dhënave personale, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në përdorimin dhe ndarjen e të dhënave si numrat e identifikimit personal, numrat e telefonit, adresat e emailit, adresat e banimit, etj.

Udhëzime për Përdorimin e Historive të Të Tjerëve

Ka disa çështje të tjera të rëndësishme për t'u marrë në konsideratv kur përdorim historitë personale, informacionet dhe intervistat e të tjerëve në projektet tona të vetë-rrëfimit. Mbajeni këtë listë pranë për t'u siguruar që po krijoni një projekt etik, respektues dhe profesional:

- Gjithmonë kërko leje për të treguar historinë e dikujt ose për të përdorur elemente prej saj. Siç e kemi parë, marrja e pëlqimit të informuar për pjesëmarrjen e një

²⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32016R0679>

personi në një intervistë ose për përdorimin e pjesëve të historisë së tyre është pjesë thelbësore për të përfaqësuar ndershmërisht dhe saktësisht realitetin e tyre, si dhe për të përfshirë ata në procesin e rrëfimit të historisë.

- Së pari dhe mbi të gjitha, mos shkakto dëm. Duhet të synojmë gjithmonë të mbrojmë burimet tona, qoftë kjo përmes anonimitetit, dhënies së pak detajeve identifikuese, apo zgjedhjes së kujdesshme të pjesëve të historisë që ndajmë dhe mënyrës se si e tregojmë atë. Asnjëherë nuk duhet të ndajmë pjesë të historive të dikujt që mund të dëmtojnë karakterin e tyre ose t'i ekspozojnë ndaj ndonjë rreziku. Këtu është e rëndësishme të theksohet se si qëllimi ynë, ashtu edhe pasojat e tij, duhet të jenë të padëmshme!
- Sigurohu që është historia jote për ta treguar, ose reflekto sërish pse je ti personi më i duhur për ta treguar atë. Kjo përfshin pyetje si: çfarë nuk të pëlqen nga mënyrat se si është treguar më parë kjo histori dhe si mund ta përmirësosh ti? Përse personi që tregon historinë duhet të ndihet rehat duke ta treguar ty?
- Përfshi komunitetet që tregojnë historitë e tyre. Respekto dhe promovoni mënyrat në të cilat vetë komuniteti i prekur dëshiron ta tregojë historinë e tij, termat që përdor, faktet që i konsideron të rëndësishme dhe arsyet për këtë. Trajtojini ata si ekspertë dhe veten si lehtësues të procesit.
- Verifiko gjithmonë të dhënat, faktet dhe zërat e zgjedhur në projektet e vetë-rrëfimit në mënyrë që të japësh një pamje të plotë dhe të saktë të situatës. Kjo ndihmon për të përfaqësuar me ndershmëri njerëzit që tregojnë historitë e tyre dhe për ta vendosur të vërtetën e tyre brenda një konteksti më të gjerë.
- Trego një pamje të plotë dhe komplekse të një komuniteti. Mos u përqendro vetëm në traumat dhe "reziliencën" e tyre. Trego gjithashtu kulturën e pasur, njohuritë tradicionale, etj. Shmang narrativat që fokusohen vetëm tek vuajtja ("trauma porn"), duke e balancuar atë me pjesët e tjera të historisë së tyre.
- Shmang tregimet e "historisë së vetme" për grupe apo komunitete të caktuara. Gjithmonë përpiku të paraqesësh njerëzit dhe komunitetet si qenie të plota dhe komplekse, jo si grupe të njëtrajtshme, dhe ki kujdes të mos përforcosh stereotipe negative apo narracione të thjeshtuara.
- Shmang paternalizmin dhe "të tjetërsimin" e njerëzve dhe komuniteteve që tregojnë historitë e tyre, veçanërisht kur vjen puna te rrëfimet nga një perspektivë eurocentrike ose e Veriut të Globit. Në punën tone duhet të besojmë që vetë njerëzit që ndajnë historitë janë autoritetet më të mira mbi përvojat e tyre dhe t'i lejojmë ata të tregojnë ato në kushtet e tyre, pa gjykime dhe vlerësime nga pozita privilegji.
- Kur shkruan dhe strukturon historinë tënde, mendo për 5W-të:
 - Kush po e tregon historinë dhe kush do ta marrë atë?
 - Çfarë duhet të tregohet?
 - Pse po e tregon? (Çfarë rezultati do të doje të arrije?)

- Si duhet të tregohet kjo histori që të përmbushë këto qëllime?
- Gjithashtu mendo për Kur dhe Ku po tregohet historia për të ndihmuar në pranimin e saj dhe mundësinë për të frymëzuar ndryshim ose veprim të mëtejshëm.
- Mendo se si mund të ndash fuqinë, privilegjin, njohuritë dhe mjetet e tua për të lehtësuar projekte vetë-narracioni, ku komunitetet tregojnë historitë e tyre, sipas kushteve të tyre (dhe më pas vepro!).

Një shembull interesant i gazetarisë narrative që vë në qendër historitë e të tjerëve është programi radiofonik dhe podcasti *This American Life*, në transmetim që nga viti 1995. Ky projekt krijon histori të fuqishme, prekëse dhe njerëzore mbi tema komplekse.

MODULI 4 - UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E IMAZHEVE

Në projektet e vetë-rrëfimit, ku aspekti multimedial shpesh është thelbësor për tregimin e historive, narracionin dhe dokumentimin e aktiviteteve, është e rëndësishme të përcaktohen udhëzime të qarta për përdorimin e imazheve. Këto udhëzime ndër të tjera duhet të përfshijnë disa aspekte si të drejtat e përdorimit, konfidencialiteti, etika dhe cilësia e imazheve.

Duke ju referuar projektit EUR(H)OPE si shembull, gjeni më poshtë janë disa pika kyçe për të marrë në konsideratë gjatë përzgjedhjes dhe përdorimit të imazheve dhe përmbajtjeve të tjera vizuale për projektin tënd të vetë-rrëfimit.

Si të Përzgjedhim Imazhe që Përputhen me Rrëfimin Tonë

- Përzgjedhja e imazheve bazuar në histori: Imazhet duhet të përputhen me historitë që tregohen dhe të pasqyrojnë përvojat e të rinjve dhe komuniteteve. Zgjidh imazhe që përforcojnë temat e projektit tënd. Në rastin e projektit EUR(H)OPE, këto përfshijnë: migracionin, identitetin, qytetarinë aktive dhe bashkëpunimin ndërkulturor.
- Koherenca midis konteksteve: Edhe pse konteksti kombëtar mund të ndryshojë, është e rëndësishme të ruhet një koherencë tematike. Kjo mund të arrihet duke përdorur imazhe që shprehin emocione të ngjashme dhe domethënëse (si shpresa, këmbëngulja dhe solidariteti) dhe që përputhen me narrativën e përgjithshme të projektit.

- Dukshmëria e ndikimit: Zgjidh imazhe që tregojnë veprime konkrete (si pjesëmarrja në punëtori, shkëmbime ndërkulturore apo kurse trajnimi) dhe momente kyçe (fjalime, debate, ndërveprime etj.).

Sugjerime për Linjën Vizuale të Projektit

- Mesazhet kryesore: Fokusimi vizual i projektit duhet të pasqyrojë misionin e tij. Për shembull, në projektin EUR(H)OPE, çdo imazh duhet të përcjellë vlerat e diversitetit, përfshirjes, solidaritetit dhe fuqizimit të të rinjve.
- Përfaqësimi vizual i vlerave: Imazhet duhet të ilustrojnë aftësinë e të rinjve për të shprehur veten, për të marrë pjesë aktive në shoqëri dhe për të kapërcyer sfida të lidhura me kontekstet sociale dhe migratore.
- Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive: Duhet të theksohet pjesëmarrja aktive e të rinjve, qoftë në punë në grup, diskutime apo aktivitete krijuese (arti, gazetari etj.).

Referimi i Burimeve për Imazhet dhe Prodhimet Fotografike

- Licencat Creative Commons: Nxsis përdorimin e imazheve të disponueshme nën licenca Creative Commons, duke respektuar gjithmonë kushtet (atributim, ndarje e njëjtë, jo-komercializim).
- Bankat falas të imazheve: Përdor platforma të njohura që ofrojnë imazhe falas, cilësore dhe pa honorarë, si:
 - [Unsplash](#): Imazhe me rezolucion të lartë, përdorim i lirë pa nevojë regjistrimi.
 - [Pexels](#) dhe [Pixabay](#): Këto platforma ofrojnë një gamë të gjerë temash me imazhe pa pagesë.
- Bankat me pagesë të imazheve: Për nevoja më specifike, bankat si Shutterstock, Adobe Stock ose Getty Images ofrojnë imazhe profesionale, por kërkojnë blerjen e licencës.
- Fotografët lokalë: Sa herë të jetë e mundur, bashkëpunoj me fotografë lokalë për të kapur imazhe që reflektojnë realitetet specifike të projektit në secilin vend pjesëmarrës.

Rregulla për Përdorimin e Drejtë të Imazheve: Lejet dhe Meritat e Autorit

- Cilësia vizuale: Imazhet duhet të jenë me rezolucion të lartë për të siguruar që mund të përdoren në formate të ndryshme (print, video, rrjete sociale, raporte etj.).

- Përdorimi korrekt: Mos e ndrysho një imazh në mënyrë që të shtrembërosh kuptimin apo kontekstin origjinal. Prerjet, retushimet apo efektet vizuale duhet të respektojnë integritetin e mesazhit të imazhit.
- Meritat e autorit: Çdo imazh duhet të shoqërohet me informacionin e duhur. Duhet të përfshijë emrin e autorit, burimin dhe kushtet e licencës, nëse është e nevojshme.
- Përdorimi në rrjete sociale dhe faqe interneti: Gjatë shpërndarjes së imazheve në platforma publike, është thelbësore të përmenden kreditimet dhe të përdoren përshkrime ose hashtag-e që respektojnë etikën dhe misionin e projektit.
- Arkivimi dhe mbrojtja: Imazhet duhet të ruhen në mënyrë të sigurt, duke mbajtur kopje të të gjitha pëlqimeve të marra. Kjo siguron që nëse imazhet do të ripërdoren në të ardhmen, ato të jenë në përputhje me të drejtat dhe privatësinë.

Përdorimi i Imazheve në Vetë-rrëfim

Ilustrimi i rrëfimeve personale

Fotografite dhe imazhet duhet të lidhen drejtpërdrejt me historitë që ndajnë të rinjtë pjesëmarrës. Ato duhet të forcojnë rrëfimin, duke sjellë një dimension vizual plotësues, qoftë për një mesazh personal apo kolektiv. Një imazh i përzgjedhur me kujdes mund të japë një ndjesi më të thellë dhe autentike për përvojën që po tregohet, duke ndihmuar publikun të lidhet më fort me rrëfimin.

Përfshirja e përmbajtjes multimediale

Kur është e mundur, përdorni imazhet në kombinim me mjete të tjera si audio, video apo tekst. Kjo qasje multimediale pasuron përvojën e shikuesit ose lexuesit, duke e bërë më të gjallë dhe më tërheqëse historinë. Për shembull, një dëshmi zanore mund të shoqërohet me fotografi që pasqyrojnë momentet kryesore të rrëfimit ose video të shkurtëra që tregojnë procesin krijues të pjesëmarrësve.

Elemente të Respektimit të Privatësisë lidhur me Narrativat Diskriminuese dhe/ose të Pasjellshme (disrespectful)

Mbrojtja e pjesëmarrësve

Është thelbësore të shmangni përdorimin e imazheve që mund të dëmtojnë dinjitetin e njerëzve të përfshirë, sidomos në rastet kur historitë kanë të bëjnë me migrimin apo tema

të ndjeshme. Asnjëherë mos publikoni imazhe që mund t'i ekspozojnë individët ndaj diskriminimit, paragjykimeve ose rrezikut.

Pëlqimi i informuar

Përpara se të fotografoni apo të përdorni një imazh, sigurohuni që të keni marrë pëlqimin e qartë dhe të informuar nga secili person që shfaqet në të. Shpjegoni me qartësi se si dhe ku do të përdoren imazhet. Ky proces është veçanërisht i rëndësishëm në kontekste migratore, ku ruajtja e konfidencialitetit shpeshherë është jetike për sigurinë dhe mirëqenien e personave të përfshirë.

Përfaqësimi i drejtë

Kujdesuni që të shmangni portretizimin e pjesëmarrësve si viktime apo të përforconi stereotipe negative. Zgjidhni të tregoni histori që shfaqin forcën, kreativitetin dhe përfshirjen aktive të tyre në shoqëri. Imazhet duhet të pasqyrojnë njerëz të angazhuar, dinamikë dhe që kontribuojnë në komunitetet e tyre.

Elemente Ligjore mbi Përdorimin e Imazheve të të Miturve dhe/ose Kategorive të Tjera të Vulnerabël

Pëlqimi i prindërve

Në rast se fotografoni të mitur, është e domosdoshme të merrni miratimin me shkrim nga prindi ose kujdestari ligjor përpara se të publikoni ose të përdorni imazhet për qëllime publike. Në këtë pëlqim duhet të saktësohet mënyra dhe qëllimi i përdorimit të imazhit.

Mbrojtja e grupeve vulnerabël

Për popullatat vulnerabël, si refugjatët, migrantët, personat me aftësi të kufizuara, etj., mbrojtja e konfidencialitetit dhe sigurisë personale është prioritet. Asnjë imazh nuk duhet të publikohet pa pëlqimin e qartë dhe të informuar të personit. Në disa raste, anonimiteti—p.sh. fotografimi nga prapa ose shmangia e shfaqjes së fytyrës—mund të jetë opsioni më i sigurt, sidomos kur ka rrezik për identitetin ose dinjitetin e tyre.

Rregulloret kombëtare

Çdo partner në projekt duhet të respektojë legjislacionin vendas që rregullon përdorimin e imazheve, veçanërisht ato të të miturve. Është detyrë e partnerëve që të verifikojnë dhe të veprojnë në përputhje me ligjet në fuqi në secilin shtet pjesëmarrës.

Përdorimi i imazheve në një projekt vetë-rrëfimor duhet të përputhet me parimet më të larta etike, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e individëve, si dhe duke forcuar mesazhet kryesore të projektit. Këto udhëzime garantojnë një qasje të përgjegjshme dhe profesionale në menaxhimin e përmbajtjes vizuale.

Rregullat e mësipërme mund dhe duhet të përshtaten sipas konteksteve lokale, specifike kulturore dhe kuadrit ligjor të çdo vendi që merr pjesë në projektin tuaj.

MODULI 5 - UDHËZIME PËR ARKIVIMIN DHE POST-PRODUKSIONIN

Arkivimi i Materialeve

Gjatë punës së raportimit dhe procesit të vetë-rrëfimit, është thelbësore të siguroheni që të gjitha të dhënat e mbledhura (imazhe, intervista, regjistrime zanore, video, etj.) të arkivohen siç duhet dhe të ruhen në kopje rezervë. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të shmangur humbjen e të dhënave, por edhe për të garantuar sigurinë e tyre digjitale. Nëse informacioni konfidencial nuk menaxhohet në mënyrën e duhur, mund të shfaqen probleme ligjore ose të sigurisë kibernetike. Prandaj, është e rëndësishme që skedarët që përmbajnë informacione të ndjeshme të ruhen në mënyrë të sigurt, të jenë lehtësisht të identifikueshëm vetëm për ju dhe për anëtarët e autorizuar të organizatës suaj.

Në terma praktikë, nuk ka një formulë fikse për mënyrën e emërimit të skedarëve apo dosjeve; secili duhet të zhvillojë një metodë që i përshtatet stilit të tij, të jetë e thjeshtë për t'u mbajtur mend dhe për t'u zbatuar. Më e rëndësishmja është që ky proces të bëhet në kohë reale, gjatë gjithë rrjedhës së projektit, dhe jo të lihet për në fund.

Partnerët e projektit EUR(H)OPE japin disa këshilla praktike për ruajtjen dhe arkivimin e skedarëve:

- Organizoni dosjet tuaja në mënyrë të rregullt dhe përdorni emra që kanë kuptim dhe që mund të kujtohen lehtësisht. Zgjidhni një metodë konsistente për emërtimin e tyre. Për shembull, mund të përdorni datën, emrin e projektit dhe një përshkrim: *"20240823_EUR(H)OPE_ruajtjadigjitale"*.

- Bëni gjithmonë një ose më shumë kopje rezervë të skedarëve tuaj për të shmangur humbjen e materialeve. Falë natyrës digjitale të tyre, është e lehtë të krijoni kopje që mund t'ju ndihmojnë në raste emergjente.
- Ruani kopje të materialeve në vende të ndryshme. Kjo do të thotë që nëse humbni një dosje në një pajisje, e keni akoma të disponueshme në një tjetër. Për shembull, mund ta ruani në kompjuterin personal, në një hard-disk të jashtëm dhe në një shërbim "cloud".
- Për skedarët që përmbajnë të dhëna konfidenciale, konsideroni mbrojtjen me fjalëkalim, ruajtjen në dosje të fshehura ose në disqe të enkriptuara. Mund të përdorni edhe emërtime që ju sinjalizojnë që bëhet fjalë për material sensitiv, pa qenë të kuptueshme për të tjerët.
- Rekomandohet që intervistat dhe regjistrimet të ruhen në vende të sigurta, me akses të kufizuar vetëm për ju dhe anëtarët e ekipit tuaj, për të garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Udhëzime për Prodhimin dhe Post-produksionin e Materialeve

Pasi të keni planifikuar dhe realizuar intervistat, mbledhur të gjitha informacionet dhe materialet vizuale (fotografi, infografikë, etj.), dhe keni përgatitur bazën për projektin tuaj të vetë-rrëfimit, mund të kaloni në fazën e prodhimit dhe pasprodhimit. Ndërkohë që strukturoni historinë tuaj, verifikoni të gjitha faktet dhe informacionet, dhe përgatitni përmbajtjen përfundimtare në fazën e pas-prodhimit, merrni parasysh këto udhëzime:

- Filloni të punoni me produktin final vetëm pasi të keni në dispozicion të gjitha materialet e mbledhura. Kjo do t'ju ndihmojë të shihni "pamjen e madhe" dhe si lidhen pjesët me njëra-tjetrën.
- Rillexoni ose rishikoni intervistat tuaja (jo menjëherë pas përfundimit të tyre!) për të pasur një perceptim më të qartë mbi atë që është thënë dhe si mund të kontribuojë në historinë tuaj. Pasi t'i keni rishikuar, përfshijini me kujdes në raportimin tuaj.
- Vendosni nëse historia do të tregohet në vetën e parë nga vetë narratori apo do të nevojiten edhe zëra të tjerë. Shtoni perspektiva të reja vetëm kur ka një arsye të fortë, për shembull, sepse jeni vetë dëshmitar, pjesë e ngjarjes, apo keni një kontribut të drejtpërdrejtë mbi temën.
- Kontrolloni dy herë që të gjitha mendimet dhe perspektivat e ndryshme që dolën nga intervistat të jenë të përfaqësuara drejt në produktin final. Sigurohuni për saktësinë e deklaratave të personave të intervistuar dhe përfaqësimit të drejtë të historisë në tërësi, duke përfshirë të gjitha këndvështrimet.

- Përfshini në produktin përfundimtar çdo përmbajtje multimediale të rëndësishme që ka lidhje me rrëfimin.
- Kryeni një kontroll final për saktësinë e emrave, vendeve, informacionit, citimeve dhe çdo përmbajtje tjetër që mund të cenojë ndjeshmërinë ose konfidencialitetin e dikujt.
- Praktikë e mirë është të ndani tekstet apo produktet përfundimtare me personat e intervistuar përpara publikimit. Nëse ka ndonjë dyshim ose debat rreth një elementi të caktuar, dhe ju keni regjistrimin për të vërtetuar atë që është thënë, mund ta mbani atë pjesë në histori. Megjithatë, është më e rëndësishme të tregoheni të kujdesshëm për mënyrën si ndihen njerëzit në lidhje me mënyrën se si janë përfaqësuar dhe si rrëfimi i tyre është përcjellë.

ZBATIMI I PAKETËS SË VETË-RRËFIMIT

Përveç përmbajtjes teorike dhe shumë sugjerimeve të dobishme, këshillave praktike dhe shembujve konkretë që kemi përfshirë përgjatë kësaj Pakete për Vetë-Rrëfim, jemi të lumtur të ndajmë me ju edhe disa informacione shtesë që do t'ju ndihmojnë të sintetizoni gjithçka që keni mësuar deri më tani dhe t'i përshtatni këto njohuri sipas nevojave dhe konteksteve tuaja personale.

Seksionet në vijim kanë për qëllim t'ju ndihmojnë të kuptoni bazat e ndërtimit të një projekti vetë-rrëfimi, si dhe t'ju ofrojnë disa shembuj konkretë aktiviteteve që mund t'i vini në praktikë me të rinj, punonjës rinorë apo çdo grup tjetër, me synimin për t'i frymëzuar dhe fuqizuar ata të tregojnë historitë e tyre përmes një procesi kolektiv vetë-rrëfimi. Mos hezitoni t'i përshtatni këto struktura dhe aktivitete shembull, sipas nevojave, interesave, dëshirave, kontekstit dhe audiencës suaj, për të nxitur sa më shumë krijimtarinë dhe individualitetin e përvojës së çdo personi apo grupi!

Si të Ndërtoni një Histori Vetë-Rrëfimi

1. Përcaktoni qartë projektin e historisë suaj: Çfarë historie duam të tregojmë? Pse? Pse besojmë se kjo histori ka një vlerë universale? Pse besojmë se jemi personat e duhur për ta treguar?
2. Bëni studim dhe kërkim
Analizoni si është treguar kjo histori më parë, nëse është treguar. Kjo do t'ju

ndihmojë të gjeni këndvështrimin tuaj unik dhe mënyrën se si dëshironi ta zhvilloni më tej.

3. Përpiloni një listë me të gjithë zërat që kanë rëndësi në këtë temë
Sigurohuni që të përfshini sa më shumë këndvështrime të ndryshme mbi këtë çështje. Kujdesuni që këta zëra të jenë përfaqësues dhe të rëndësishëm – qofshin persona të zgjedhur nga komuniteti apo individë që kanë përvoja personale aq të vlefshme, sa janë thelbësore për rrëfimin tuaj.
4. Hartoni një listë intervistash me personat dhe komunitetet kyçe, dhe caktoni takimet
Organizoni mirë kohën dhe mënyrën e zhvillimit të këtyre intervistave.
5. Planifikoni dhe realizoni fazën e prodhimit të projektit tuaj
Kjo përfshin regjistrimin e intervistave, realizimin e fotografive, krijimin e infografikëve apo çdo materiali tjetër vizual që shkon në përputhje me projektin tuaj.
6. Me të gjitha informacionet dhe materialet e mbledhura, ndërtoni strukturën e historisë suaj
Zhvilloni një hark narrativ të qartë dhe përcaktoni cilat informacione apo detaje praktike do të përfshini, sipas formatit që keni zgjedhur (shkrim, podcast, dokumentar video, projekt fotogazetarie, etj.).
7. Verifikoni të gjitha faktet dhe informacionet që keni mbledhur dhe përdorur në rrëfimin tuaj
Sigurohuni që projekti juaj vetë-rrëfimor të jetë i vërtetë, në përputhje me standardet e gazetarisë së mirë, dhe mbi të gjitha, të jetë një histori respektuese dhe fuqizuese për komunitetet e përfshira.
8. Përfundoni me një fazë të mirë post-produksioni
Përpiloni materialin përfundimtar, editoni, ruani kopjet rezervë dhe arkivoni të gjitha materialet tuaja në mënyrë të qartë dhe të rregullt.

Shembull Aktiviteti

Aktiviteti 1: Krijimi i një Podcast-i

Ky aktivitet do t'ju udhëheqë hap pas hapi në krijimin e një podcast-i të shkurtër (10-15 minuta), duke përdorur parimet e gazetarisë narrative të shpjeguara në Self-Telling Kit. Ai mund të realizohet brenda një mëngjesi pune, por ju gjithmonë mund ta zgjasni kohën për t'i dhënë mundësi pjesëmarrësve të krijojnë një produkt më të përpunuar dhe profesional.

Hapi 1: Brainstorming dhe përzgjedhja e temës (09:45 – 10:00, 15 minuta)

- Pasi të jeni ndarë në grupe të vogla, bashkëbisedoni dhe propozoni ide për të zgjedhur një temë që ju intereson dhe për të cilën keni njohuri paraprake. Kjo do t'ju ndihmojë të krijoni një rrëfim të fortë për podcast-in tuaj.
- Pyetjet udhëzuese për brainstorming:
 - Çfarë historie duam të tregojmë?
 - Pse jemi ne personat e duhur për ta treguar?
 - Pse është e rëndësishme të tregojmë këtë histori?

Hapi 2: Hartimi i pyetjeve dhe struktura e historisë (10:00 – 10:30, 30 minuta)

- Pasi keni zgjedhur temën (sa më specifike, aq më e thjeshtë për t'u trajtuar!), punoni së bashku për të hartuar pyetjet e intervistës.
- Sigurohuni që rrëfimi të ndjekë strukturën e mëposhtme, siç shpjegohet në Paketën e Vet-rrëfimit:

1. Prezantimi/Ekspozita: Prezantimi i situatës, vendit ku ndodh ngjarja, temës kryesore dhe personazheve kyç.
2. Zhvillimi i ngjarjes: Renditja e ngjarjeve, duke nxjerrë në pah konfliktin kryesor dhe ngritjen e tensionit.
3. Kulmi i historisë: Momenti dramatik i kthesës dhe ulja e tensionit.
4. Përfundimi: Zgjidhja dhe mbyllja e historisë.

Hapi 3: Ndarja e roleve dhe planifikimi (10:30 – 10:45, 15 minuta)

- Vendosni se kush do të jetë prezantuesi (intervistuesi) dhe kush do të jetë i intervistuari.
- Për të intervistuarin, sigurohuni që çdo informacion, statistikë apo fakt i përmendur të jetë i saktë dhe i verifikuar.
- Planifikoni hyrjen dhe përfundimin e podcast-it:
 - Hyrja: Prezantimi i shkurtër i prezantuesit dhe i të intervistuarit. (Nëse është e nevojshme, referohuni te drafti i Paketës së Vet-rrëfimit.)
 - Mbyllja: Një përfundim i shkurtër, i qartë dhe i natyrshëm për të përmbyllur podcast-in.

Pushim kafeje (10:45 – 11:00, 15 minuta)

Hapi 4: Prova e intervistës/podcast-it (11:00 – 11:45, 45 minuta)

- Praktikoni strukturën e podcast-it dhe simuloni intervistat për të siguruar rrjedhshmëri dhe natyrshmëri para regjistrimit.

Hapi 5: Regjistrimi i podcast-it (11:45 – 13:00, 1 orë e 15 minuta)

- Çdo grup realizon regjistrimin e podcast-it në studio.
- Kujdes! Podcast-i nuk duhet të zgjasë më shumë se 10-15 minuta.

Paçi fat, bukuroshë! <3

Aktiviteti 2: Video vetë-rrëfimi

Ky aktivitet do t'ju udhëzojë përmes hapave bazë që nevojiten për të krijuar një projekt të shkurtër të tregimit përmes videos (maksimumi 5-10 minuta), mbështetur në parimet e gazetarisë narrative dhe vetë-rrëfimit. Skenari është shkruar për një aktivitet që mund të realizohet brenda një dite të plotë ("sesion provë"), por mund ta përshtatni lehtësisht për të krijuar projekte më të zgjeruara të tregimit përmes videos, duke zgjatur kohën e lejuar për çdo hap (veçanërisht për fazat e regjistrimit dhe post-produksionit!).

Hapi 1: Brainstorming dhe Përzgjedhja e Temës (09:45-10:00, 15 minuta)

- Ndahuni në grupe me 2-4 persona dhe bashkë diskutoni për të zgjedhur një temë që është interesante dhe e rëndësishme për të gjithë anëtarët e grupit.
- Duhet të keni njëfarë njohurie paraprake mbi temën, në mënyrë që të krijoni një rrëfim të fortë.
- Përdorni pyetjet e mëposhtme për të udhëhequr brainstorm-in:
 - Çfarë historie duam të tregojmë?
 - Pse jemi ne personat e duhur për ta treguar?
 - Pse është e rëndësishme të tregojmë këtë histori?

Hapi 2: Hulumtimi dhe Mbledhja e Informacionit (10:00-10:30, 30 minuta)

- Pasi të keni zgjedhur temën, analizoni më thellë se çfarë lloj historie dëshironi të tregoni dhe çfarë informacioni ju nevojitet për ta realizuar.
- Kjo mund të përfshijë teknika si:

- Mini-intervista me anëtarët e grupit për të vendosur se cilët elementë janë kyç për tregimin e historisë.
- Hulumtim në internet për të mbledhur më shumë informacione, të dhëna dhe shembuj mbi temën.
- Përcaktimi i narrativës kryesore që dëshironi të përçoni përmes videos.

Hapi 3: Struktura e Historisë dhe Planifikimi Vizual (10:30-11:00, 30 minuta)

- Me të dhënat e mbledhura, hartoni strukturën e historisë tuaj duke përdorur letër dhe stilolaps ose mjete online si [Miro](#).
- Sigurohuni që rrëfimi të ndjekë një hark narrativ të qartë:
 1. Prezantimi/Ekspozita: Prezantimi i situatës, ambientit, temës kryesore dhe personazheve kyç.
 2. Zhvillimi i ngjarjes: Rendi i ngjarjeve, konflikti kryesor dhe ngritja e tensionit.
 3. Kulmi i historisë: Momenti dramatik dhe ulja e tensionit.
 4. Përfundimi: Zgjidhja dhe përmbyllja e historisë.
- Planifikoni aspektet vizuale, duke marrë parasysh elementët e mëposhtëm:
 - a. Regjistrimi i intervistave me personazhe kyç.
 - b. Xhirimi i pamjeve të ndryshme nga terreni.
 - c. Regjistrimi i zërave apo sfondit audio.
 - d. Fotografitë, infografikët dhe materiale grafike të tjera.

Pushim Kafeje (11:00-11:30, 30 minuta)

Hapi 4: Shkrimi i Skenarit për Çdo Element (11:30-12:00, 30 minuta)

- Merrni listën e elementëve vizualë dhe shkruani një skenar për secilën pjesë që do të udhëzojë xhirimet. Kjo do t'ju ndihmojë të menaxhoni më mirë kohën dhe të shmangni përsëritjet e panevojshme gjatë xhiritimit.
 - Për intervistat, përpiloni një listë me pyetje dhe bëni një provë të shkurtër.
 - Për xhirimin e pamjeve dhe zërave në terren, mendoni për vendet e duhura dhe kohëzgjatjen e klipave.
 - Për fotografi, mendo se ku do t'i realizosh ose ku mund të shkarkosh nga interneti fotografi pa të drejtë autori.
 - Për infografikat, vizualizimet e të dhënave dhe materiale të tjera grafike, mendo se ku mund t'i shkarkosh këto elementë me licenca Creative Commons, ose si mund t'i krijosh vetë (duke përdorur programe si [Canva](#), për shembull), si dhe sa kohë do të të duhet për t'i përgatitur.

Hapi 5: Prodhimi – Regjistrimi dhe Mbledhja e Materialeve (12:00-14:00, 2 orë)

- Duke ndjekur skenarin dhe planin tuaj, dilni në terren (ose punoni online) për të regjistruar dhe mbledhur të gjithë përmbajtjen e nevojshme.
- Ndani punën mes anëtarëve të grupit sipas vendndodhjes dhe kohës së nevojshme për regjistrim, për të përdorur kohën në mënyrë efikase.
- Sigurohuni që çdo skedar të ruhet me një titull të qartë për ta lehtësuar fazën e post-produksionit (p.sh.: Intervista_Carlos_Event1).

Drekë (14:00–15:30, 1 orë e 30 minuta)

Hapi 6: Post-Produksioni – Editimi i Videos dhe Shpërndarja (15:30–17:30, 2 orë)

- Pasi të keni mbledhur të gjitha materialet vizuale, përdorni programe falas si [Clipchamp](#) ose [Adobe Express](#) për të ngarkuar dhe edituar materialet.
- Nëse dëshironi të krijoni një rrëfim më interaktiv, mund të përdorni programin [Stornoway](#), i cili lejon përdoruesit të ndërveprojnë me videon ndërsa e shikojnë.
- Kur të përfundoni përmbajtjen, mund ta ndani në [YouTube](#), [Vimeo](#), rrjetet sociale ose në çdo platformë tjetër sipas dëshirës suaj!

Aktiviteti 3: “Histori Përkatësie” – Krijimi i një Narrative Fotografike

Qëllimi: Të eksplorohet dhe të dokumentohet identiteti evropian dhe ndjenja e përkatësisë përmes foto-gazetarisë, duke inkurajuar pjesëmarrësit të angazhohen me komunitetet e tyre lokale dhe të reflektojnë mbi vlerat dhe përvojat e përbashkëta.

Kohëzgjatja: 5.5 – 7 orë (mund të zgjatet në më shumë se një ditë, sipas nevojës).

Raundi 1: Hyrje dhe Përgatitje (30 minuta)

1. Prezantim në Foto-gazetaria
 - Shpjegimi i bazave të tregimit të historisë përmes fotografisë: kompozimi, drita, kornizimi dhe kapja e emocioneve.
 - Diskutim mbi aspektet etike: respektimi i privatësisë, marrja e pëlqimit dhe paraqitja e subjekteve me dinjitet.
2. Zhvillimi i Temës
 - Prezentimi i temës: *“Përkatësia në një Evropë që Ndryshon”*.

- Inkurajoni pjesëmarrësit të reflektojnë: Çfarë do të thotë për ta ndjenja e përkatësisë në komunitetin e tyre? Si ndërthuren migrimi, kultura dhe identiteti në këtë kuadër?

Raundi 2: Puna në Terren – Gjetja e Historisë (3–4 orë)

1. Ndërveprimi me Komunitetin
 - Pjesëmarrësit zgjedhin një temë ose një subjekt që mishëron idenë e përkatësisë. Shembuj të mundshëm:
 - Një emigrant që ndan përvojën e tij/saj për gjetjen e shtëpisë në një vend të ri.
 - Një takim rinor që shfaq shkëmbimin kulturor.
2. Dokumentimi përmes Fotografisë
 - Shkrepni një seri prej 5–7 fotografish që tregojnë një histori të plotë rreth subjektit të zgjedhur.
 - Sigurohuni që çdo imazh të ketë një funksion specifik: të prezantojë ambientin, të theksojë emocionet apo veprimet që ndodhin.

Raundi 3: Zhvillimi i Narrativës (1 orë)

1. Përzgjedhja dhe Renditja
 - Pjesëmarrësit rishikojnë materialin e mbledhur dhe zgjedhin fotot më përfaqësuese për të ndërtuar një rrjedhë narrative logjike.
 - Rendit imazhet në një sekuencë logjike që forcon dhe pasuron tregimin e historisë.
2. Shkrimi i Përshkrimeve (Caption-eve)
 - Shkruani një përshkrim të shkurtër për secilën fotografi, duke ofruar kontekst dhe thelluar kuptimin për publikun.

Raundi 4: Prezantimi në Grup & Reflektimi (1 – 1.5 orë)

1. Prezantimi i Historive
 - Çdo pjesëmarrës apo grup prezanton narrativën e vet fotografike përpara grupit të gjerë.
 - Diskutoni për sfidat gjatë procesit, vendimet që u morën dhe çfarë u mësua nga kjo përvojë.

2. Feedback & Reflektim

- Lehtësoni një diskutim mbi mënyrën se si këto histori lidhen me temat më të gjera të identitetit dhe përkatësisë evropiane.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të reflektojnë mbi fuqinë e rrëfimit vizual si një mjet për advokim dhe ndryshim social.

Materialet e Nevojshme:

- Kamera ose smartphone me cilësi të mirë për fotografi.
- Fletore ose pajisje digjitale për shënime dhe shkrimin e përshkrimeve.
- Kopje të formularëve të pëlqimit (nëse është e nevojshme).

Rezultatet që Priten:

- Zhvillimi i aftësive në tregimin vizual të historive dhe gazetari.
- Thellimi i kuptimit të identitetit evropian dhe përvojave të ndryshme brenda komuniteteve lokale.
- Krijimi i produkteve konkrete (narrativa fotografike) që mund të ekspozohen gjatë aktiviteteve të projektit

Përfundime

Kjo Paketë Vetë-Rrëfimi nuk synon vetëm të ofrojë bazat mbi gazetarinë narrative dhe teknikat e vetë-tregimit, por edhe sugjerime konkrete për të ndihmuar pjesëmarrësit të tregojnë histori të ndjera përmes projekteve personale. Shpresa jonë është të frymëzojmë pjesëmarrësit të zhyten në përvojat e tyre personale dhe kolektive, duke e kthyer rrëfimin në një akt ndarjeje të thellë dhe njerëzore.

Gazetaria narrative nuk kufizohet vetëm në transmetimin e fakteve, por fton publikun të jetojë dhe reflektojë mbi histori të rrëfyera nga vetë njerëzit që i kanë përjetuar ato. Në një botë ku shumë tema trajtohen në mënyrë sipërfaqësore, projekti EUR(H)OPE përpiqet të rikthejë vlerën e dimensioneve emocionale dhe subjektive të rrëfimeve, duke i bërë ato më të prekshme dhe të kuptueshme për një audiencë më të gjerë.

Shpresojmë që informacioni, mjetet dhe strukturat e kësaj pakete të jenë të dobishme për projektet tuaja personale apo në punën me të rinj, punonjës rinorë dhe komunitete të ndryshme. Nëse i ndani publikisht historitë tuaja, na informoni ose na tag-oni në [Instagram](#) apo [Facebook](#) ose na shkruani në [EUR\(H\)OPE project](#), që të mund t'u gëzohemi dhe ne dhe t'u japim më shumë zë!

Falenderime

Kjo Paketë Vetë-Rrëfimi u krijua falë bashkëpunimit të katër partnerëve të projektit EUR(H)OPE (Kodi i Projektit: ERASMUS-YOUTH-2023-CB-101131392) i bashkë-financuar nga ERASMUS+ i Bashkimit Evropian në linjën "Capacity Building for Youth" Prill 2024 – Mars 2026.

Përmbajtja e kësaj pakete dhe materialeve të tjera të projektit pasqyron pikëpamjet e autorëve dhe Komisioni Evropian nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin e informacionit të dhënë.

Faleminderit partnerëve për bashkëpunimin aktiv në krijimin e këtij materiali:

Përmbajtja dhe Koordinimi

Rachele Renno & Christian Elia, Club Social QCODE

Entenela Ndrevataj & Rea Nepravishta, Qendra Uja

Danielle Bishop & Mariana Pfenniger, CEPS Projectes Socials

Safouane Oumha & Moustapha Ben Mouh, Fundación Amigos de Marruecos

Redaktimi dhe Rishikimi

Danielle Bishop & Mariana Pfenniger, CEPS Projectes Socials

Ilustrimi Grafik

Sofia Nardacchione, Club Social QCODE